


| | |
|--|------------------|
|  Universiteti i Prizrenit University of Prizren Universitet Prizren "UKSHIN HOTI" | |
| Pranuar me dt | 30.12.2019 |
| Zyra e pranimit | Nr. i protokolit |
| 308 | 01-485/A |



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
 Prizren, Republika e Kosovës.
 Tel +381 (0) 29- 232 140;
 Homepage: www.uni-prizren.com

RREGULLORE PËR SHKOLLËN VERORE
NDËRKOMBËTARE NË UNIVERSITETIN
"UKSHIN HOTI" PRIZREN

Prizren, Nëntor 2019



Në bazë të dispozitave ligjore të nenit 42 dhe 47-të, në Statutit e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren (tutje referuar si UUHP-ë), në mbledhjen e mbajtur me datë ____ .11.2019, Senati i këtij Universiteti e miratoi:

Rregulloren për Shkollën Verore Ndërkombëtare në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1.

Me këtë rregullore përkufizohet baza ligjore për themelimin dhe funksionimin e Shkollës Verore Ndërkombëtare në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren (tutje referuar si Shkolla Verore Ndërkombëtare), emërtimi i së cilës në gjuhën angleze është, “Prizren International Summer School (PISS)”. Kjo rregullore definon, dhe përkufizon misionin, vizionin, organizimin, fushëveprimtarinë, funksionet, përgjegjësitë, kompetencat dhe detyrat e Shkollës Verore Ndërkombëtare.

Misioni, dhe vizioni i Universitetit Veror Ndërkombëtar

Neni 2.

Misioni i Universitetin Veror

Misioni i Universitetit Veror Ndërkombëtar, është që të promovoj dhe zhvilloj vlerat akademike dhe hulumtuese të UUHP-së, si dhe ato të trashëgimisë kulturore të rajonit në të cilin vepron, në kohezion me nevojat për mobilitet të studentëve, të stafit akademik, shkëmbim të përvojave të hulumtimit, avancim të procesit të rrjetëzimit ndërkombëtar dhe rritje të diversitetit ndërkulturor.

Neni 3.

Vizioni i Universitetin Veror

Vizioni i Shkollës Verore Ndërkombëtare, është që ta shfrytëzojë potencialin e saj lidhur me diversitetin e mjedisit akademik, historik, turistik, kulturor, fetar dhe lingual në funksion të ndërtimit e një qendre rajonale të bashkëpunimit kërkimor-shkencor dhe mobilitetit akademik. Në planin afatgjatë, nëpërmjet kapaciteteve të Shkollës Verore Ndërkombëtare, UUHP-ja, mëton të shëndrrohet në një qendër Evropiane të mobilitetit akademik, me theks të veçantë në fushat e teknologjisë informative, biznesit



ndërkombëtar, agrobiznesit, mbrojtjes së mjedisit, zhvillimit bashkëkohorë të edukimit, gjuhësisë dhe albanologjisë si dhe të drejtës ndërkombëtare.

Neni 4.

Struktura organizative e Shkollës Verore Ndërkombëtare

1. Senati i UUHP-së, me qëllim të organizimit sa më të mirë të Shkollës Verore Ndërkombëtare, çdo vit në muajin janar do të themeloj një Këshill Organizativ të Shkollës Verore Ndërkombëtare;
2. Këshilli Organizativ do të ketë në përbërje 7 (shtatë) anëtarë.
3. Struktura e Këshillit Organizativ do të përbëhet nga:
 - a) 3 (tre) anëtarë të stafit akademik dhe administrativ të UUHP-së;
 - b) 1 (Një) anëtarë i stafit administrativ të UUHP-së;
 - c) 2 (dy) anëtarë nga stafi akademik përfaqësues të Universiteteve partnere; dhe
 - d) 1 (një) anëtarë përfaqësues i shoqërisë civile.
4. Senati i UUHP-së, e emëron çdo vit koordinatorin e Shkollës Verore Ndërkombëtare.
5. Koordinatorit të Shkollës Verore Ndërkombëtare do t'i ofrohet mbështetje dhe përkrahje e plotë, duke pëfshirë kapacitetet e stafit administrativ dhe infrastrukturës së Universitetit, në funksion të organizimit dhe mbarëvajtjes së suksesshme të Shkollës Verore Ndërkombëtare.
6. Këshilli Organizativ dhe Koordinatori i Shkollës Verore Ndërkombëtare janë përgjegjës për organizimin e aktiviteteve brenda kësaj Shkolle Verore.
7. Këshilli Organizativ e harton Udhëzuesin për studentët dhe dokumentet tjera të Shkollës Verore Ndërkombëtare.

Neni 5.

Përgjegjësit e organizimit të moduleve të Shkollës Verore Ndërkombëtare

1. Shkolla Verore Ndërkombëtare ofron module (kurse) intensive në formë të ligjeratave dhe ushtrimeve, në kohëzgjatje prej dy javësh. Modulet propozohen dhe organizohen nga njësitë akademike të UUHP-së, të listuara si më poshtë:
 - a) Fakulteti i Shkencave Kompjuterike;
 - b) Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit;
 - c) Fakulteti i Edukimit;
 - d) Fakulteti i Ekonomisë;



- e) Fakulteti Juridik;
 - f) Fakulteti i Filologjisë.
2. Modulet nga këto njësi akademike, do të caktohen me vendim të Senatit, me propozimin paraprak të njësisive akademike, si dhe në bashkëpunim me partnerët dhe palët tjera të interesit.
 3. Modulet e Shkollës Verore Ndërkombëtare organizohen nga Stafi Akademik i UUHP-së dhe nga Stafi Akademik i ftuar nga Universitetet tjera.

Neni 6.

Procedura e aplikimit të studentëve pjesëmarrës të Shkollës Verore Ndërkombëtare

1. Studentët duhet të jenë të regjistruar në një institucion të arsimit të lartë;
2. Studentët për pranim në Universitetin Veror duhet të zotërojnë mirë gjuhën angleze.
3. Studentët duhet të shprehin interesin e tyre për modulin (kursin).
Studentët duhet të dorëzojnë një CV dhe dokumentet përcjellëse me aplikacionin e tyre në internet në platformën online. Me plotësimin e aplikacionit dhe përzgjedhjen e modulit, studenti konfirmon se i ka lexuar dhe pranuar rregullat e pjesëmarrjes.
4. Studentët mund të aplikojnë për modulin (kursin), vetëm përmes formularit elektronik në web-faqen e UUHP-së.
5. Formulari i aplikimit do të jetë i qasshëm për studentët, në web-faqen e UUHP-së.
6. Aplikimet për modulet, vlerësohen nga Këshilli Organizativ i Shkollës Verore Ndërkombëtare. Këshilli Organizativ e rezervon të drejtën për të mohuar mundësinë e hyrjes në një modul, në rast se studenti aplikant nuk i plotëson kërkesat e pranimit.
7. Studentët kanë të drejtë të aplikojnë në ato module, ata që kanë respektivisht dymbëdhjetë kredi ECTS-ë.
8. Studentët janë të obliguar të marrin pjesë rregullisht në seancat e moduleve, gjatë periudhës së mbajtjes së Shkollës Verore Ndërkombëtare.

Neni 7.

Të drejtat dhe obligimet e studentëve pjesëmarrës

1. Pas përfundimit të suksesshëm të modulit, studenti pjesëmarrës do të pajiset me një certifikatë si rezultat i përfundimit me sukses të modulit.



2. Studentët mund të pajisen edhe me një deklaratë të pjesëmarrjes dhe vlerësimit.
3. Studentëve pjesëmarrës u sigurohen të gjitha lehtësirat e nevojshme gjatë periudhës së Shkollës Verore Ndërkombëtare.
4. Studentët kanë mundësinë të shfrytëzojnë bibliotekën e UUHP-së, kabinetet e informatikës, laboratorët dhe resurset tjera të universitetit.
5. Studentët e Universiteteve të tjera brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës kanë të drejtë të marrin pjesë në Shkollën Verore Ndërkombëtare, dhe t'i gëzojnë të gjitha të drejtat.
6. Studentët pjesëmarrës obligohen që të respektojnë të gjitha rregulloret e zbatueshme për UUHP-në.
7. Këshilli Organizativ i Shkollës Verore Ndërkombëtare rezervon të drejtën të përjashtoj çdo pjesëmarrës i cili nuk i respekton rregulloret e zbatueshme për UUHP-në.

Neni 8.

Përzgjedhja e profesorëve ligjërues për modulet e Shkollës Verore Ndërkombëtare

1. Senati i UUHP-së, me propozimin e Këshillit Organizativ dhe në koordinim me këshillat e fakulteteve, përzgjedh profesorët që do të marrin pjesë si ligjërues në Shkollën Verore Ndërkombëtare.
2. Përzgjedhja e profesorëve ligjërues bëhet në bazë të kushteve të thirrjes publike, e cila hapet çdo vit, në përputhje me modulet që i ofron Shkolla Verore Ndërkombëtare.

Neni 9.

Aktivitetet tjera

1. Shkolla Verore Ndërkombëtare do të organizoj edhe aktivitete tjera gjatë periudhës së organizimit të Shkollës Verore Ndërkombëtare. Ndër të tjera mund të organizohen:
 - a) tryeza të rrumbullakëta,
 - b) punëtori tematike;
 - c) seminare profesionale;
 - d) ligjerata të hapura me personalitete të rëndësishme publike;
 - e) promovime të librave dhe punimeve artistike; dhe,
 - f) aktivitete tjera artistike, kulturore, dhe sportive.



Neni 10.

Tarifat e pjesëmarrjes dhe financimi i Shkollës Verore Ndërkombëtare

1. Tarifat e pjesëmarrjes në Shkollën Verore Ndërkombëtare përcaktohen çdo vit me vendimin e Këshillit Drejtues të UUHP-së.
2. Pjesëmarrësit në Shkollën Verore Ndërkombëtare marrin përsipër të gjitha kostot që lidhen me pjesëmarrjen e tyre në Shkollën Verore Ndërkombëtare, përfshirë këtu shpenzimet e akomodimit, udhëtimit, sigurimit shëndetësor, sigurimit të udhëtimit, ushqimit etj.
3. Buxheti për organizimin dhe mbarëvajtjen e Shkollës Verore Ndërkombëtare përcaktohen çdo vit me vendimin e Këshillit Drejtues të UUHP-së. Planifikimin e buxhetit e bënë Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Ngritje të Cilësisë në bashkëpunim me Prorektorin për Buxhet, Financa dhe Infrastrukturë.
4. Shkolla Verore Ndërkombëtare ka të drejtë të pranoj donacione dhe përkrahje financiare nga organizatat qeveritare, joqeveritare, private, vendore dhe ndërkombëtare.

Neni 11.

Periudha e organizimit të Universitetit Veror Ndërkombëtar

1. Shkolla Verore Ndërkombëtare organizohet në muajin korrik ose gusht të çdo viti.
2. Kalendari i saktë i organizimit të Shkollës Verore Ndërkombëtare përcaktohet nga Senati i UUHP-së, në bashkëpunim me partnerët akademik, dhe palët tjera të interesit.


Neni 12.

Ndryshimi, hyrja në fuqi dhe zbatimi

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati i UUHP-së.
2. Gjithashtu kjo rregullore mund të plotësohet, dhe ndryshohet me kërkesën e Rektorit dhe me miratimin nga ana e Senatit të UUHP-së.



Kryesuesi i Senatit të PUHP-së



Prof. Asoc. Dr. Ismet Topaj

